



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSELDNIKA/MAYOR'S OFFICE

26.09.2023
Nr. i Protokollit: 02/ 837

Procesverbal nga dëgjimi publik me Grupe të Nënpërfaqësuara (Gra, të rinj, pensionistët, persona me aftësi të kufizuar etj.)

E mërkurë, më 21 shtator 2023

Kohëzgjatja e takimit: 14:00 –15:40

Vendi i takimit: Salla e Kuvendit

Pjesëmarrës në takim: Kryetari i Komunës – Qemajl Aliu, Nënkyetari i Komunës – Faruk Beqa, Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini; Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme - Valon Januzi dhe Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik – Kastriot Shabani, Drejtoresha e Arsimit – Yllka Fejzullahu, Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport – Albana Fazliu, Drejtoresha e Inovacionit dhe Projekte – Gonxhe Osmani, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike – Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

1. Draft-Plani Buxhetor Komunal për periudhën 2024-2026

Qemajl Aliu – Kryetar i Komunës : Të dashur qytetar, të nderuar kolegë, bashkëpunëtor, media, të gjithë që jeni të pranishëm sot në këtë sallë në kuadër të ftesës të cilën e kemi bërë për kornizën e dytë buxhetore. Mirë se keni ardhur dhe faleminderit që keni gjetur kohë që sot të jeni me ne. Prezenca e qytetarëve dhe qytetaria aktive është ndihmë e madhe dhe është dorë e djaththë e punës së mirë për ne si qeverisje në Komunën e Shtimes, sa më masovike prezenca e qytetarëve aq më mirë është edhe qeverisja, kështu që prezenca sa më e madhe në numër sot na bënë të kuptojmë që qytetarët janë aktiv, janë të lirë t'i shprehin kërkeshat e tyre dhe t'i adresojnë nevojat e tyre dhe problemet që kanë, nga vendbanimet dhe nga fushat të cilat vin.

Ju e dini që qarkorja e parë apo korniza e parë buxhetore është mbajtur në secilin vendbanim dhe aty janë adresuar të gjitha nevojat, kërkeshat dhe shqetësimet e qytetarëve. Tani jemi në prag të draftimit dhe votimit të buxhetit, që është në ditët e fundit të muajit shtator. Ju e dini që buxheti i komunës është një nga pikat kryesore dhe nëse ky buxhet formohet duke u mbështet në kërkeshat dhe priorititet e qytetarëve, me transparenc dhe barazi ashtu siç jemi zotuar, kjo na bënë edhe ne të ndihemi mirë edhe realizohen punët me vullnetin më të madh për qytetarët.

Realisht shumica e kërkeshave janë adresuar, ne për këtë kornizë të dytë buxhetore do të mbajmë dy dëgjime publike, ky sot është i pari dhe në kuadër të këtij dëgjimi publik ne kemi ftuar përfaqësues nga grat, të rinjt, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar dhe eventualisht për

ndonjë qytetar për kërkesat, nevojat ose shqetësimet të cilat nuk ka pasur kohë dhe mundësi t'i adresoj në kornizën e parë buxhetore.

Buxheti i Komunës së Shtimes këtë vit është rrith 9.9 milion, ku mbi 55% e buxhetit shkon për dikasterin e pagave dhe mëditjeve, investime kapitale janë dikun rrith 2.4 milion dhe pjesa tjetër janë subvencione dhe mallra dhe shërbime. Në vitin 2021 e kemi gjetur buxhetin dikun me 7.8 milion dhe brenda këtyre dy viteve pothuajse 2.2 milion është rrith buxheti i Komunës së Shtimes, si reflektim dhe fal buxhetit qendoror. Kësaj radhe domethënë i kemi 1 milion më shumë dhe do të kemi mundësi që me këto mjete të kemi projekte më shumë, subvencione më shumë, mundësi më shumë që të bëjmë projekte në të mirë të qytetarëve tonë.

Ju kisha lut seçilit nga ju nesë keni të adresoni diçka, që nuk keni mundur ta adresoni në kornizën e parë buxhetore, sot e keni fjalën e keni të drejtën të adresoni ndaj qeverisë tonë. Me mua sot të pranishëm janë edhe drejtoret e të gjithave dikastereve, është edhe Zyrtari kryesor financiar dhe nesë e sheh të arsyeshme z. Ferati mund të jap më shumë hollësi dhe detaje për buxhetin vjetor 2023-2024. Pastaj pyetjet dhe adresimi mund të bëhen duke filluar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, z. Emini, por edhe nga drejtoret e drejtive të tjera që sot janë prezent. Edhe njëherë faleminderit shumë që sot jeni prezent dhe mund të vazhdoni me kërkesat e juaja.

Bujar Ferati – Zyrtari Kryesor Financiar : Përrshëndetje për të gjithë qytetarët e Komunës, njëherëshit ju falënderoj për pjesëmarjen në këtë takim i cili është i një rëndësie shumë të veçant për drejtimin e buxhetit të ardhshëm të Komunës tonë. E laboroi edhe Kryetari i Komunës pjesën e parë të dëgjimeve publike, të cilat i kemi mbajtur me qytetar dhe kemi arritur të ndërtojmë një draft-buxhet, mirëpo kërkesa, baza ligjore, transparenca, puna dhe angazhimi i jonë vazhdon prap në bashkëpunim me ju, që aty ku kemi ngecje të japim mendime, propozime për pjesën tjeter të këtij buxheti, i cili shkon në finalizim në Kuvend para datës 30 shtator.

Unë në pikë të shkurtërdo do të jap shifra për shumën e buxhetit të komunës tonë sipas qarkores së dytë buxhetore. Total buxheti është 9.906.819 euro, që në raport me vitin e kaluar është rrith për 1.150.779 euro, domethënë kemi buxhet pak më të rrith se në vitin e kaluar.

Struktura buxhetore u tha më herët, ku pjesa më e madhe e buxhetit për vitin 2024 shkon për kategorinë e pagave 5.604.111, kurse në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 1.133.279, shpenzimet komunale 220.000, subvencionet 350.000.

Nëse ndonjëri prej jush ka ndonjë pyetje apo diçka ne mund të japim edhe sqarime më në detaje, përndryshe unë po i'a jap fjalën Drejtorit të Urbanizmit, Grejtalb Eminit që mundësisht së paku t'i përmend projektet të cilat janë projekt për këtë vit, por nëse ka nevojë edhe projektet të cilat janë duke u zhvilluar e që kanë qenë në proces për dy vitet edhe atë 23 dhe 24, por edhe projektet të cilat janë për 2024 e që janë projekte të reja që kanë buruar nga kërkesat e qytetarëve.

Edhe njëherë ju falënderoj shumë dhe po i'a jap fjalën Drejtorit Emini.

Grejtalb Emini – Drejtor për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi: Faleminderit Bujar, përrshëndetje për të gjithë, shumicën e fjalëve i tha Bujari dhe Kryetari. Ne i kemi përgatitur projektet për investimet kapitale, drejtoria për planifikim urban, kadastër dhe gjeodezi, ka 22 projekte të reja pa i përfshirë edhe projektet që janë 2 vjeçare, gjithsej janë 2.5 milion në investime kapitale, që përfshihen të gjitha drejtorit, ku shumicën e investimeve kapitale i ka drejtoria e planifikimit urban.

Ne në qarkoren e parë, siç e tha edhe kryetari kemi qenë në secilin fshat dhe i kemi marr kërkesat, mirëpo ka pasur mundësi që dikush ska pas kohë të jetë në ato takime prandaj është mirë që të shfrytëzohet sot ky takim dhe të paraqiten kërkesat. Nuk mund të bëjmë ndryshime të mëdha për shkak të kufive buxhetor të cilat Bujari vetëm sa i potencoi. E rëndësishme është se secili fshat është i përfshirë në buxhetin e komunës, në secilin fshat ka investim. Ne jemi të hapur për çdo kërkesë të cilën ju e keni kështu që mos na kurseni. Ju faleminderit!

Kërkesat e qytetarëve :

- **Ejup Salihaj** : Në Mollopolc, të rregullohen gypat në lagjen “Salihaj”, pasi që kur ka të reshura të shiut kemi vërvime, si dhe asfalti është i prishur.
- **Ahmet Ahmeti** : Planifikimet për kryerjen e punëve në teren, a mbahen në Komunë, që të mund të ngritet shqetësimet nga vetë komuniteti i fshatrave?
A mund të ngritet një shqetësim, i cili nuk ka të bëjë me buxhetin komunal, pasi që jam vetë penzionist dhe nga ky Kuvend të ngritet qështja që ka diskriminime në rastet e penzionimit të moshuarve për shkak të pengesave 15 vjeçare ?
Të rregullohet rruga“ 10 Qershori”.
Tek memoriali në Reçak, duhet të intervenohet dhe të bëhet një muri mbrojtës.
- **Idajet Rexhepi** : Për buxhetin e vitit 2024 të ndahet fondi prej 50 mijë eurove për pagesën e Kryetarëve të fshatrave si dhe propozimi i dytë të ndahen 25 mijë euro për funksionin shtesë të komisioneve.
- **Ismet Zeqiri** : Nuk kemi punëtor teknik tek Shoqata e Penzionistëve dhe pastërtia nuk është në nivel si dhe kemi probleme me parkingun sepse është i vogël.
Në fshatin Muzeqinë, rruga tek shkolla është e ngushtë dhe duhet të zgjerohet, po ashtu duhet të ju jepet një vërejtje arsimtarëve për parkimin e veturave të tyre në rrugë.
- **Skender Dauti**: Të rritet numri i zjarrfiksëve në komunën e Shtimes.
- **Lulzim Sahiti**: Kërkoj të rregullohet trotuari i papërfunduar përgjatë lumit “Shtimjanja” nga rruga “Afrim Selmanaj” deri tek rruga “Përparim Boshnjaku”, si dhe të bëhet ndriçimi publik në këtë hapësirë.
- **Lirim Halimi** : Lumi Shtimjanja dhe parku në Muzeqinë a janë në projekt buxhet për vitin 2024?
Gypat të cilët kalojnë rrith Xhamisë, po krijojnë probleme nëse mund të intervenohet.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik

Data: 21.09.2023

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
1	Donjeta Qorollli	DQorollli
2	Ardit Xhemajli	Ardi X.
3	Fetllum Xhemajli	Fetllum X.
4	Gencster Xhaixhi	Gencster X.
5	Bukurije Xhemajli	Bukurije X.
6	Festina Hasani	Festina H.
7	Armen Fazliu	Armen F.
8	FRESKIM Agjetti	Freskim A.
9	Hekuran Nura	Hekuran N.
10	Edon Haxhi	Edon H.
11	MUSTAFË Flaziri	Mustafë Fl.
12	Hatinxhe Sejdici	Hatinxhe S.
13	Lanitë Ahmeti	Lanitë A.
14	Msemet Logari	Msemet L.
15	SANIJO SADIQI	Sanijo S.
16	RREZARTË RAMADANI	Rrezzartë R.
17	Jirim Halimi	Jirim H.
18	Hazmi Moshini	Hazmi M.
19	Shaban Halimi	Shaban H.
20	Ahmet Ahmeti	Ahmet A.
21	Ergjë Sabri	Ergjë S.
22	Adem Ramadani	Adem R.
23	Vilka Fecizullahu	Vilka F.

24	Bandyl Rushiti	Rashiti
25	Ahnan Ahmeti	Ahmeti
26	Gentiana Mehmeti	Gentiana
27	Gonxhe Osmani	Gonxhe
28	Albana Fazliu	Fazliu
29	Bassiror Shemzizi	Shemzizi
30	Bujar Ferati	Ferati
31	Gjektaib Emini	Emini
32	Gjikimtar Misimi	Misimi
33	Shqipe Miftari	Miftari
34	Eliza Imeri	Imeri
35	Sheribane Bojremi	Bojremi
36	Valdete Hosani	Hosani
37	Hajla Kurishi	Kurishi
38	Valmira Hoxha	Hoxha
39	Sadbere Halili	Halili
40	Kaltrina Azemi	Azemi
41	Habibe Rashiti	Rashiti
42	Zeynije Veliu	Veliu
43	Jelizim Salihi	Salihi
44	Jolejt Rekhepi	Rekhepi
45	VALON JANUZI	Januzi
46		
47		
48		
49		
50		
51		
52		
53		





